



ALBSIG
INVEST



PJESË E
KASTRATI GROUP

Prospective i Fondit të Pensionit Vullnetar Albsig



TABELA E PËRMBAJT JES

1	INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME	4
2	PËRKUFIZIME	5
3	POLITIKA E INVESTIMIT DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT	6
3.1	Instrumentet e lejuara	6
3.2	Politika e investimeve	7
4	INFORMACIONI MBI FONDIN DHE PERFORMANCËN E TIJ	8
4.1	Të dhënat historike	8
5	RREZIQET KRYESORE TË INVESTIMIT NË FOND	9
5.1	Rreziku i Tregut	9
5.2	Rreziku i Inflacionit	10
5.3	Rreziku i Kredisë	10
5.4	Rreziku i Likuiditetit	10
5.5	Rreziku Operacional	11
5.6	Rreziku i Përputhshmërisë	11
5.7	Rreziku i Reputacionit	11
5.8	Rreziku i Agjencisë	11
5.9	Rreziku i ndryshimit të tatimit mbi pensionin vullnetar	12
5.10	Rreziku Ligjor	12
5.11	Rreziku Politik	12
6	MASAT QË DO MERREN PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT	12
7	KONTRIBUTET E ANËTARËVE NË FONDIN E PENSIONIT	13
8	DETYRIMET TATIMORE	13
9	LEHTËSITË TATIMORE PËR PUNËDHËNËSIN	14
10	TRAJTIMI TATIMOR I PËRFITIMEVE TË MARRA NGA ANËTARI	14
11	PAGESA E PENSIONEVE	14
12	TËRHEQJA E PARAKOHSHME	16
13	VDEKJA E ANËTARIT	17
14	PROCEDURA PËR TËRHEQJEN E ASETIVE NGA LLOGARIA INDIVIDUALE	17
15	PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES SË ANËTARËSISË NË FONDIN E PENSIONIT	18
16	TRANSFERIMI I LLOGARISË INDIVIDUALE	18
17	TARIFAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE	18
17.1	Tarifa e Administrimit	18
17.2	Tarifa e Transferimi	19
17.3	Tarifa të Tjera	19
18	BANKA DEPOZITARE	19
19	EMRI DHE SELIA E AUDITUESIT TË JASHTËM	20
20	SHOQËRIA ADMINISTRUESE	20
21	FONDET NËN ADMINISTRIM	20
22	ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE	21
22.1	Asambleja e Aksionarëve	21
22.2	Këshilli i Administrimit	21
23	ADMINISTRATORËT	22

Emërtimi i Fondit:	Fondi i Pensionit Vullnetar Albsig (në vijim "Fondi")
Shoqëria Administruese:	ALBSIG INVEST Sh.a - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (në vijim "Shoqëria Administruese") e regjistruar në regjistrin tregtar me, NIPT L92208025J, me seli në adresën: Rruga e Barrikadave, Albsig HG, Kati 8, Tiranë.
Data e Krijimit të Fondit:	22 Nëntor 2019
Data e Fillimit të Veprimtarisë:	4 Shkurt 2020
Data e Publikimit:	Prill 2021

1 INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Prospekti është dokumenti kryesor që kontribuesit duhet të lexojnë për t'u njohur me karakteristikat e Fondit, parimet e investimit, si dhe rregullat që do shoqërojnë anëtarësimin në Fond.

Ligji për fondet e pensionit, nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar", i ndryshuar dhe aktet nënligjore që pasojnë atë janë baza e aktivitetit dhe operacioneve të Fondit.

Fondi i Pensionit Vullnetar, është një alternativë për të patur të ardhura shtesë përveç pensionit të garantuar shtetëror. Fondi është krijuar për të shmangur problematikat e sistemit shtetëror, ku si rrjedhojë e rritjes së jetëgjatësisë nuk u siguron të ardhura të mjaftueshme një pjese të madhe të popullsisë kur arrijnë moshën e pensionit.

Një Fond Pensioni Vullnetar është i përbërë nga një grup asetesh, të investuara nga kontributet e anëtarëve dhe zotërohet bashkarisht nga të gjithë anëtarët ku pjesët përpjestimore të pronësisë përfaqësohen nga kuota në fond.

Fondi menaxhohet nga Shoqëria Administruese, me qëllim optimizimin e kthimit nga investimi duke minimizuar rrezikun, për t'u siguruar anëtarëve të Fondit të ardhura në moshën e pensionit. Ndër seksionet kryesore të prospektit është politika e investimit, e cila tregon se ku do investojë Fondi pasi Shoqëria Administruese duhet të respektoj me përpikmëri investimet vetëm në asetet e treguara në këtë seksion. Anëtarët potencialë duhet të lexojnë me vëmendje se në çfarë asetesh investon Fondi dhe të bëjnë zgjedhjen e duhur nëse toleranca e tyre për rrezik përkon me tiparet e asetëve që do investojë Fondi.

Fondi i adresohet klientëve konservator me tolerancë të ulët rreziku. Fondi do investojë vetëm në obligacione afatgjata të Republikës së Shqipërisë. Tradicionalisht obligacionet qeveritare janë aseti me rrezikun më të ulët ndër asetet e tjera në tregun e kapitaleve.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) me adresë Rruga "Dora D'Istria", Nr.10 P.O. Box 8363, Tiranë, Shqipëri ushtron mbikëqyrjen mbi aktivitetet e Shoqërisë Administruese, të Fondit dhe Depozitarit.

Shoqëria Administruese, krahas administrimit të fondeve të pensionit vullnetar, është e licencuar dhe për administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, sipas licencës nr. 5, datë 22.11.2019, lëshuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

Asetet e Fondit të Pensionit janë të ndara nga asetet e Fondit të Investimit dhe nga asetet e Shoqërisë Administruese.

Këshilli i Administrimit mban përgjegjësi të plotë për përmbajtjen e prospektit.

2 PËRKUFIZIME

- Aset** - letra me vlerë, para dhe pasuri të tjera, të cilat janë në pronësi të anëtarit të Fondit të Pensionit;
- AMF** - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- Anëtar** - personi fizik, në emër dhe në përfitim të të cilit është hapur një llogari pensioni në Fondin e Pensionit dhe që ka të drejtë të përfitojë në të ardhmen nga Fondi i pensionit në bazë të kontratës me shoqërinë administruese, në masën e zotërimit të kuotave;
- Depozitari** - banka e nivelit të dytë, e licencuar nga Banka e Shqipërisë, për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit si dhe e licencuar nga AMF, për të ofruar shërbime depozitimi për asetet e Fondit të Pensionit;
- Fond pensioni vullnetar** - grup asetesh në pronësi të anëtarëve të Fondit të Pensionit;
- Fitim nga kapitali** - të ardhurat nga diferenca e çmimit të asetëve;
- Këshilli i Administrimit** - organi i shoqërisë administruese me funksione administrimi dhe mbikëqyrjeje;
- Kontribuues** - anëtari në Fond Pensioni, punëdhënësi i tij ose çdo person i tretë, që paguan kontributet e pensionit në llogarinë e pensionit të anëtarit të Fondit të pensionit;
- Kuotë pensioni** - pjesa përpjesëtimore e pronësisë në grupin e asetëve të Fondit të Pensionit që përfaqëson pjesë të barabartë pronësie të asetëve të Fondit të Pensionit, ku vlera totale e të gjitha kuotave të Fondit të Pensionit është e barabartë me vlerën totale neto të asetëve të këtij Fondi;
- Kthim nga investimi** - produkti, që merret nga investimi i asetëve dhe fitimi nga kapitali;
- Letra me vlerë (tituj)** - tituj shtetëror ose instrumente financiare të negociueshëm që emetohen dhe tregtohen për sigurimin e fitimit, nëpërmjet administrimit të të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i tyre. Mund të jenë tituj të pjesëmarrjes në kapital, tituj borxhi, aksione dhe kuota të fondit të investimeve ose fondit të pensioneve;
- Rating (vlerësim) i letrave me vlerë** - renditje e letrave me vlerë, e kryer nga agjencitë ndërkombëtare të klasifikimit, sipas nivelit të rrezikut që lidhet me investimin në to dhe kthimin nga investimi¹ ;
- Portofol** - investimet e kryera me asetet e Fondit;
- Diversifikim i portofolit** - investim i asetëve në instrumente të ndryshëm për të zvogëluar rrezikun nga investimi;
- Menaxher i portofolit** - personi përgjegjës në Shoqërinë Administruese për administrimin e portofolit;
- Përfitime** - pagesat në para, në momentin e daljes në pension, të shumave, që gjenden në llogarinë anëtarit të Fondit;
- Plan pensioni** - marrëveshja (kontrata) e personit me Shoqërinë Administruese, për ofrimin e përfitimeve për pension.
- Plan pensioni profesional** - marrëveshja (kontrata) e punëdhënësit me Shoqërinë Administruese, për ofrimin e kontributeve për pension për punëmarrësit e tij;
- Shoqëri Administruese** - shoqëri aksionare, e krijuar sipas ligjit nr.9901/2008² , i ndryshuar dhe e licencuar nga AMF, për të administruar një ose disa fonde pensioni dhe/ose sipërmarrje të investimeve kolektive;
- Transferimi i asetëve** - transferimi i asetëve nga një fond pensioni në një fond tjetër, pavarësisht nga shoqëria që e administron atë.

1. Klasifikimi me A, A2 dhe A3 përfaqëson rrezik të ulët (pritshmëria për kthimin nga investimi është e ulët); B, BB dhe BBB përfaqëson rrezik mesatar; C konsiderohen me rrezik të lartë (kanë pritshmëri kthimi më të lartë nga investimi).

2. Si dhe çdo ndryshimi apo zëvendësimi të mëvonshëm të tij.

3 POLITIKA E INVESTIMIT DHE ADMINISTRIMI I RREZIKUT

3.1 Instrumentet e lejuara

Asetet e Fondit do të investohen në përputhje më kërkesat e ligjit dhe akteve rregullatore duke u ofruar anëtarëve të Fondit siguri dhe përfitime nga investimi. Në këtë kuadër do të respektohen kërkesat ligjore dhe rregullatore për investimin e asetëve sipas kërkesave të nenit 63 të ligjit 10197/2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" si dhe të nenit 2 të Rregullores së AMF, nr.1/2010 "Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të lejuar të investimit të Fondit të Pensionit", e ndryshuar, i cili parashikon që asetet e një Fondi Pensioni mund të investohen vetëm në:

1. Bono thesari, obligacione, dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Republika e Shqipërisë;
2. Bono thesari, obligacione, dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga një shtet anëtar i BE-së ose i OECD-së ose nga bankat qendrore përkatëse;
3. Bono thesari, obligacione, ose letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore;
4. Llogari rrjedhëse dhe depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
5. Letra borxhi të klasifikuara si BBB ose më të lartë, sipas Standard & Poor's ose Fitch, Baa3 ose më të lartë sipas Moody's ose BBB (e ulët) ose më të lartë sipas DBRS (Dominion Bond Rating Service);
6. Aksione ose kuota të fondeve të investimit të licencuara në një shtet anëtar të BE-së dhe që kanë si qëllim të vetëm investimin në indekset në vijim: CAC 40, DAX, FTSE 100, S&P 500, Mesatarja Industriale e Dow Jones, Nikkei 225 (Japoneze), Sensex (Indiane), All Ordinaries (Australiane) dhe Indeksi Hang Seng (Hong Kong), ose në obligacione, bono thesari dhe letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të BE-së.

Asetet e Fondit të Pensioneve do të investohen në drejtimet e mësipërme, duke mbajtur në konsideratë ndalimet dhe kufizimet që parashikon ligji dhe aktet rregullatore. Neni 65 i ligjit nr.10197/2009 nuk lejon që asetet e fondit të pensioni të investohen në:

1. aksione, obligacione dhe letra të tjera me vlerë, që nuk janë të listuara ose që nuk tregtohen në bursë, në tregun ndër bankar apo në tregje të tjera, të rregulluara nga autoriteti përkatës;
2. asetet, që nuk mund të shiten ose transferohen;
3. instrumente derivative, përveç rasteve për mbrojtjen nga rreziku i kursit të këmbimit apo nga rreziqe të ngjashme;
4. asetet fizike, që nuk kuotohen në mënyrë të rregullt në tregje të organizuara dhe për të cilat vlerësimi është i pasigurt, si antika, punime arti, mjete motorike etj.;
5. aksione, obligacione dhe letra të tjera me vlerë, të emetuara nga:
 - i. çdo aksionar i shoqërisë administruese;
 - ii. depozitari i fondit të pensionit;
 - iii. çdo person, palë e lidhur me entitetet e radhitura në nënndarjet "i" dhe "ii" të kësaj shkronje;
6. kuota të fondeve të investimeve, që administrohen nga vetë shoqëria administruese;
7. letra borxhi, të emetuara nga vetë punëdhënësi.

3.2 Politika e investimeve

Politika e Investimit për çdo fond nën menaxhim nga Shoqëria e Administrimit miratohet nga Këshilli Administrimit. Anëtarët njoftohen tre muaj përpara në mënyrë elektronike për çdo ndryshimi thelbësor të saj. Elementi thelbësor i saj është shpërndarja strategjike, ku tregohet se në cilët asete do investohen kontributet e anëtarëve.

Menaxheri i Portofolit është përgjegjës për implementimin e politikës së investimit të fondit në përputhje me ligjin, rregulloret për aktivet e lejuara, prospektin dhe rregulloret e tjera të shoqërisë administruese. Nën asistencën e analistëve të investimit monitoron kushtet e tregjeve të kapitalit, kryen analizat e investimeve dhe kryen transaksione me letra me vlerë në përputhje objektivin e fondit, me limitet e riskut, shpërndarjes strategjike dhe taktike të fondit. Raporton tek Administratorët mbi shpërndarjen e portofolit, tregtimin e letrave me vlerë dhe mbi performancën e fondit.

Menaxheri i Rrezikut monitoron ekspozimet e çdo lloj rreziku që lidhet me fondin dhe shoqërinë administruese. Kontrollon nëse çdo ekspozim dhe çdo transaksion është brenda limiteve të përcaktuara në rregulloret e brendshme të Shoqërisë Administruese dhe në rregullore të nxjerra nga AMF. Është përgjegjës për vlerësimin e aseteve të fondit dhe kontrollon aktivitetin e Menaxherit të Portofolit. Menaxheri i Rrezikut kryen (analiza e rezultatit aktual kundrejt të parashikuarit) të strategjive të ndërtuara nga strategjive të ndërtuara nga Menaxheri i Portofolit dhe kryen analizën e atribuimit (arsyet pse dhe si ka rezultuar kjo normë kthimit) të performancës së fondit.

Gjatë përpilimit të politikës së investimit Shoqëria Administruese ka konsideruar ndërtimin e një fondi me tolerancë të ulët rreziku (konservator) duke ruajtur principalin. Fondi do investoi kryesisht në obligacione afatgjatë të Shtetit Shqiptarë. Elementi i rëndësishëm që shoqëron investimin për pension është kohëzgjatja e gjatë.

Elementet kryesore të politikës së investimit:

- Objektivi: Optimizimi i normës së kthimit duke ruajtur principalin
- Toleranca për Rrezik: E ulët
- Horizonti i Investimit: Afatgjatë (10-30 vjet)
- Likuiditeti: I ulët
- Strategjia e Investimit: Fondi do të ndjek një strategji të investimit në asete afatgjata. Fondi gjithashtu ka kërkesa të ulta për likuiditet duke konsideruar kohëzgjatjen e qëndrimit të gjatë në fond dhe prurjet periodike nga pagesat automatike të skemave profesionale dhe individuale.

Duke u nisur nga këto tipare të investimit për pension, Fondi ka ndërtuar shpërndarje strategjik si më poshtë:

Nr.	Instrumenti Financiar	Objektivi
1	Titujt shtetërorë afatgjatë të emtuar e garantuar nga Qeveria e Shqipërisë	99%
2	Titujt shtetërorë të emtuar e garantuar nga shtete të BE, OECD-së, Banka Botërore (BB), Banka Qendrore Evropiane (BQE), Banka Evropiane e Investimeve (BEI)	0%
3	Depozita bankare dhe cash	1%

Shpërndarja strategjik nënkupton shpërndarje afatgjatë të fondit në titujt shtetërorë të emetuar e garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Shpërndarje në titujt të shteteve të BE-së me 0% nënkupton se Fondi nuk mund të mbaj për një kohë shumë të gjatë investime në këtë klasë aset. Gjithashtu, sepse kjo e ekspozon fondin ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

Shoqëria Administruese informon anëtarët e Fondit për ndryshimet e politikës së investimit. Politika e investimit rishikohet nga Këshilli i Administrimit dhe çdo ndryshim miratohet nga ky këshill. Çdo ndryshim i politikës së investimit do publikohet në faqen zyrtare të internetit të Shoqërisë Administruese.


4 INFORMACIONI MBI FONDIN DHE PERFORMANCËN E TIJ

Shoqëria Administruese do të publikojë çdo ditë çmimin e kuotës dhe vlerën neto të asetëve të Fondit të Pensionit në faqen zyrtare të saj www.albsiginvest.al. Çdo anëtarë do ketë të mundësuar një llogari "online" ku mund të shikoj në çdo kohë të dhënat mbi kontributet e paguara, çmimin e kuotës, performanca e fondit në kohë, dhe vlerën e tij totale neto. Në këtë adresë do publikohen dhe raportet mujore ku do pasqyrohen të dhëna mbi kompozimin e portofolit dhe performancën e fondit.

Shoqëria Administruese publikon në faqen e saj zyrtare të internetit pasqyrat financiare vjetore të audituara dhe pasqyrat financiare të fondit të pensionit vjetore dhe për periudhat raportuese të ndërmjetme gjatë vitit ushtrimor të parashikuara nga ligji dhe ato akte që rregullojnë kontabilitetin dhe aplikimin e Standardeve të Raportimit Financiar.

4.1 Të Dhënat Historike

Fondi ka filluar aktivitetin në 04 Shkurt 2020. Më datë 28 Shkurt 2021, Vlera Netë e Aseteve (NAV) të fondit rezultoi në vlerën 58,431,990.48 lekë. E ardhura e kthimit neto për periudhën 12 mujore, 28 Shkurt 2020 - 28 Shkurt 2021 rezultoi 2.04%. E ardhura neto e fondit përlllogaritet duke zbritur nga e ardhura bruto që rezultojn nga investimi kryesisht në obligacione të Shtetit Shqiptar, komisionin e administrimit. Niveli i të ardhurave neto në të ardhmën nuk është i garantuar. Të ardhurat neto të fondit varet nga ecuria e normave të kthimit të obligacioneve të Shtetit Shqiptar në të cilat investon Fondi. Normat e kthimit të obligacioneve të Shtetit Shqiptar luhet nga viti në vit dhe brenda vitit.



Shpërndarja e Aseteve më 28 Shkurt 2021

Instrumenti financiar	Vlera (në lekë)	NAV (në %)	Objektivi (në %)
Obligacione 10-vjeçare të Shtetit Shqiptar	58,077,144	99.39	99
Depozita bankare dhe cash	442,059	0.76	1

5 RREZIQET KRYESORE TË INVESTIMIT NË FOND

Investimi në asete financiare shoqërohet gjithmonë me një rrezik duke qenë se rreziku nuk mund të shmanget asnjëherë plotësisht. Çdo aset financiar përmban një kombinim midis rrezikut dhe normës së kthimit, ku sa më e lartë të jetë rreziku aq më e lartë mund të jetë norma e kthimit.

Fondi i Pensionit Vullnetar është me kontribute të përcaktuara ku përfitimet nuk janë të garantuara dhe rrezikun e investimit e mbart anëtar.

Fondi i Pensionit Vullnetar Albsig, duke investuar në tituj shtetërorë të emetuara dhe garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka një profil rreziku të lidhur ngushtë me rrezikun e qeverisë shqiptare. Obligacionet e qeverisë shqiptare janë të garantuara plotësisht nga Shteti Shqiptarë dhe si të tilla ato kanë rrezikun e mospagesës së kuponave apo të principalit (rreziku i kredisë) të ulët. Por obligacionet janë të ekspozuara nga ndryshimi i normave të interesit (rreziku nga normat e interesit) të cilat ndryshojnë sa herë Shteti Shqiptarë kryen emetime të reja për to apo nga ndryshimi i vlerësimeve individuale të tregtarëve të këtyre letrave me vlerë. Ndryshimi i normave të interesit automatikisht sjell ndryshim të normës së kthimit të fondit dhe të çdo anëtar.

Tiparet e rreziqeve që do ekspozohet fondi dhe trajtimi i Shoqërisë Administruese janë si më poshtë:

5.1 Rreziku i tregut:

Nënkupton luhatjet e vlerave të asetëve financiare si pasojë e ndryshimeve të: a) normave të interesit, dhe b) të kurseve të këmbimit. Rritja e normave të interesit sjell ulje të vlerës së asetit financiar, dhe ulja e normave sjell rritje të vlerës së asetit financiar. Luhatjet e kursit të këmbimit sjellin luhatje të vlerës së asetit të konvertuar në monedhën vendase, lekë.

Shoqëria administruese duke përdorur strategjinë e investimit të asetëve sipas detyrimeve ul ndjeshëm ekspozimin e fondit ndaj rrezikut të normave të interesit duke i konsideruar si "detyrime implicite" vlerën e asetëve të klientëve dhe kohën e tyre të daljes në pension. Por nëse një anëtar do të dali nga fondi i pensionit përpara kohëzgjatjes së investimit (10-30 vjet) mund të paralizohet nga ky rrezik nëse normat e interesit do të jenë rritur.

Asetet në valutë të huaj përmbajnë rrezikun e lëvizjes së pafavorshme të kurseve të këmbimit. Ekspozimi në valutë do jetë pothuajse 0 (zero) pasi shpërndarja strategjike është parashikuar të jetë 0% në këtë klasë aset. Nëse anëtari do dali nga fondi pensionet përpara kohëzgjatjes së investimit (10-30 vjet) mund të penalizohet nga ky rrezik.

5.2 Rreziku i Inflacionit:

Investimi për një kohë të gjatë siç është dhe investimi për pension shoqërohet me rrezikun e inflacionit, pasi rritja e përgjithshme e çmimeve nënvlerëson shumat e parave të marra në kohë shumë të largëta. Për të përlogaritur normën reale të kthimit anëtari duhet të zbres nga norma e tij e përfituar nga fondi normën e inflacionit. Gjithashtu norma e inflacionit mund të ketë ndikim tek normat afatgjatë e obligacioneve të Shtetit Shqiptarë duke i rritur ato dhe duke ulur vlerën e tyre.

Asete me të ardhura fikse siç janë obligacionet nuk janë mbrojtës shumë të mirë të inflacionit. Asetet të ashtuquajtura "reale" si aksionet, pasuritë e paluajtshme dhe mallrat janë mbrojtës më të mirë të inflacionit, por ato përmbajnë përgjithësisht më shumë rrezik se asetet me të ardhura fikse si obligacionet. Fondi i pensionit vullnetar Albsig është ndërtuar për klient konservator me tolerancë të ulët rreziku.

Shoqëria ka ndërtuar një aplikacion ku anëtarët do mund të monitorojnë një objektiv të tyre për pension, duke kontrolluar në këtë mënyrë nëse pensioni që do përfitojnë do jetë i mjaftueshëm apo jo.

5.3 Rreziku i Kredisë:

Nënkupton mospagimin nga emetuesi i asetit financiar të detyrimeve të tij në formë interesi periodik dhe/ose principali. Gjithashtu përkeqësimi i aftësisë paguese të një emetuesi reflektohet direk tek çmimi i obligacionit duke e ulur atë dhe duke ulur për rrjedhojë vlerën neto të aseteve. Përkeqësimi i aftësisë paguese vjen zakonisht nga përkeqësimi i deficitit buxhetor.

Investimi në obligacione të Shtetit Shqiptarë është i lidhur me aftësitë paguese të Shtetit Shqiptarë. Tradicionalisht rreziku i kredisë vlerësohet i ulët për obligacionet Qeveritare.

5.4 Rreziku i Likuiditetit:

Përbën pamundësinë për të shitur asetet e fondit në rast kur shoqëria duhet të përmbush detyrimet e saj për tërheqje apo shitja e asetit me çmim të pafavorshëm. Investimi i fondit në asete jo-likuide mund të sjellë ulje të normës së kthimit kur asetit shitet vetëm me një çmim shumë të pafavorshëm.

Fondi duke konsideruar që "detyrimet" e tij janë shumë afatgjata të cilat lidhen me daljen e anëtarëve në pension dhe duke konsideruar faktin që do ketë çdo muaj hyrje nga skemat profesional dhe individuale, fondi nuk e ka të domosdoshme mbajtjen e aseteve me maturime të shkurtra apo të një shpërndarje të madh në llogari monetare për arsye likuiditeti që mund të vijnë nga tërheqjet. Shoqëria do mbaj si mjete monetare dhe depozita bankare një shpërndarje strategjike prej 1%.

5.5 Rreziku Operacional:

Përbën humbjet e mundshme nga gabime apo keq funksionime të sistemeve të brendshme apo procedurave të Shoqërisë Administruese.

Shoqëria Administruese ndërton sisteme kontrolli të brendshme dhe procedura duke parandaluar rrezikun e humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabime njerëzore ose të sistemeve brenda Shoqërisë Administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose të dokumentacionit, si dhe nga procedurat e tregtimit, të vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit. Shoqëria për të administruar Fondin përdor një sistem operative i cili është ndërtuar duke respektuar parimin e 4 (katër) syve.

Gjithashtu Banka Depozitare kontrollon aktivitetin e investimeve dhe të transaksioneve me anëtarët (kontributet dhe shlyerjet).

5.6 Rreziku i Përputhshmërisë:

Është mundësia e mos përmbushjes së akteve ligjore dhe rregulloreve që bien mbi të. Kompanitë e administrimit të fondeve të pensionit dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive operojnë në një treg që është shumë i rregulluar. Ky rrezik mund të sjell efekte negative për shkak të mos-zbatimit të rregulloreve kryesisht ato që rregullojnë nivelin e kapitalit dhe parandalimit të pastrimit të parave.

Shoqëria administruese ka ndërtuar bazën e plotë rregullore të brendshme për të shmangur rrezikun e përputhshmërisë. Banka Depozitare gjithashtu kontrollon aktivitetin e investimeve dhe të transaksioneve me anëtarët (kontributet dhe shlyerjet) nëse ai është në përputhje me rregulloret dhe prospektit.

Shoqëria administruese do të ndërtojë një sistem solid të vlerësimit periodik të asetëve, humbjeve të mundshme dhe mundësisë së rritjes së kapitalit. Në të njëjtën kohë do të informojë çdo anëtar të fondit në mënyrë elektronike për rregullat e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

5.7 Rreziku i Reputacionit:

Rreziku i reputacionit është një dëmtim i emrit të mirë të shoqërisë administruese apo grupit ku ajo bën pjesë. Ky rrezik mund të vij nga sjellja e shoqërisë administruese apo nga sjelljet e punonjësve të shoqërisë administruese.

Shoqëria Administruese ndjek parime të mirëqeverisjes të shprehura në rregulloren e brendshme të saj dhe ka ndërtuar rregulla për komunikimin dhe transparencën me klientët të cilat garantojnë standarde të larta për mirëmbajtjen e reputacionit të shoqërisë administruese.

5.8 Rreziku i Agjencisë:

Rreziku i agjencisë ndodh kur administratorët e shoqërisë administruese apo dhe menaxherët e portofolit nuk marrin vendimi për rritjen e fitimit afatgjatë të shoqërisë administruese apo në shërbim të klientit por nisen nga synimet e tyre personale afatshkurtra.

Shoqëria Administruese ka ngritur rregullore të brendshme të cilat vendosin rregulla mbi sjelljet e menaxherëve të portofolit dhe administratorëve të shoqërisë administruese. Banka Depozitare gjithashtu kontrollon procesin e investimeve dhe të transaksioneve të anëtarëve dhe është një element i rëndësishëm kontrolli.

5.9 Rreziku i ndryshimit të tatimit mbi pensionin vullnetar:

Anëtarët siç pasqyrohet te seksioni VIII përfitojnë lehtësira tatimore nga anëtarësimi në Fond. Këto lehtësira tatimore aplikohet gjatë periudhës së kursimit, ndërkohë që në momentin tërheqjes së pensionit, ky pension tatóhet me normën e tatimit që do jetë në fuqi në atë moment. Periudha afatgjatë (10-30) vjet mund të sjell ndryshime në normën tatimore që do aplikohet për pensionin që do tërheq anëtari.

5.10 Rreziku Ligjor:

Rreziku ligjor shfaqet si pasoj e ndryshimeve në legjisllacionin shqiptar në lidhje me fondet e pensionit vullnetar. Ndryshime të tilla mund të sjellin trajtime të ndryshme të skemës aktuale si në drejtimin e përfitimeve tatimore ashtu dhe ndryshime në moshën e përfitimit të pensionit.

5.11 Rreziku Politik:

Kriza të theksuar politike mund të sjellin përkeqësim të aftësisë paguese të Shtetit Shqiptarë dhe për rrjedhojë uljen e vlerës së obligacioneve të tyre.

6 MASAT QË DO MERREN PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT

Shoqëria ka ndërtuar një sistem gjithëpërfshirës për administrimin e rrezikut në përputhje me parime të qeverisjes së mirë dhe menaxhimit të rreziqeve.

Shoqëria për një administrim sa më efektiv të rrezikut ka ndërmarrë këto masa:

1. Krijimin e burimeve të mjaftueshme për administrimin e rreziqeve;
2. Të ndërtojë politika dhe procedura rreziku që të jenë gjithëpërfshirëse;
3. Ndarjen e funksioneve operative dhe krijimin e kontrollove për çdo njësi;
4. Të krijojë një kulturë ku administrimi i rrezikut të jetë përgjegjësi e çdo punonjësi;
5. Ndërtimin e një njësie të dedikuar për administrimin e rrezikut, e cila do ushtroj kontroll për çdo ekspozim të Shoqërisë dhe Fondeve nën menaxhim;
6. Të monitorojë ekspozimet dhe limitet e rrezikut;
7. Të monitoroj çdo transaksion të instrumenteve financiar;
8. Të kryej analizën e rezultatit aktual kundrejt të parashikuarit të strategjive të implementuara;
9. Të kontrollojë nëse çdo transaksion kryhet në përputhje me rregullat dhe standardet më të mira;
10. Të marrë masa për parandalimin dhe minimizimin e humbjeve;
11. Të kryej analizën e arsyeve pse dhe si ka rezultuar norma e kthimit të performancave të fondeve nën menaxhim;
12. Të jetë përgjegjëse për metodologjinë e vlerësimit të aseteve financiare;
13. Të garantojë besim tek anëtarët në fond dhe te palët e treta duke ndjekur me përpikmëri çdo rregullore dhe procedurë të brendshme;
14. Të promovojë praktikrat dhe standardet më të mira në menaxhimin e fondeve të pensionit dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

7 KONTRIBUTET E ANËTARËVE NË FONDIN E PENSIONIT

Çmimi fillestar në datën e fillimit të aktivitetit të Fondit do jetë 1,000 Lekë. Data e fillimit të aktivitetit të fondit është data 04 Shkurt 2020.

Çdo pagesë kontributesh do të kryhet në numrin e llogarinë së Fondit IBAN AL76 2061 1004 0000 1003 2114 7100, të hapur pranë bankës depozitare, Banka e Tiranës Sh.ç, me të cilin shoqëria administruese ka lidhur një marrëveshje, e depozituar pranë AMF.

Kontributi minimal për tu derdhur nga çdo anëtar do jetë 1,000 (një mijë) lekë.

Pagesa e kontributeve bëhet në monedhën vendase, lekë, nga çdo person fizik që është anëtar në Fond, ose nga çdo person i tretë, në emër dhe për llogari të anëtarit ose punëdhënës (ka lidhur kontratën me shoqërinë administruese), i cili kontribuon në emër dhe në dobi të punëmarrësve të tij.

Është e rëndësishme që anëtari apo personi i tretë që kontribuon në emër të anëtarit të vendos numrin serial identifikues të anëtarit në përshkrimin e transfertës drejt llogarisë së Fondit. Ky numër serial identifikon përfituesit e çdo pagese kontributesh.

Sipas marrëveshjeve të planit të pensionit profesional, punëdhënësi do të derdhë përveç kontributeve të paguara prej tij edhe kontributet individuale të punonjësve, duke ia zbritur nga paga bruto.

Pagesat e kontributeve mund të bëhen sipas kërkesës të anëtarit (pagesë e menjëhershme, mujore, 3 mujore, 6 mujore, vjetore ose në intervale të tjerë). Kjo përcaktohet në kontratën mes anëtarit të Fondit dhe Shoqërisë Administruese.

Shoqëria Administruese konverton në kuotë pensioni kontributet e investuara në Fond dhe asetet e transferuara nga një fond tjetër, sipas çmimit të kuotës të një dite më parë (T-1) pagesës së kontributit. Çdo kuotë pensioni përfaqëson një pjesë përpjesëtimore pronësie në secilën nga asetet e Fondit. Vlera totale e kuotave në Fond është gjithmonë e barabartë me vlerën totale neto të aseteve të Fondit.

Shembulli i blerjes së një kuote pensioni:

Çmimi i kuotës së pensionit	1,500.00 lekë
Kontributi	3,000.00 lekë
Numri i kuotave të anëtarit në Fond: (3,000.00 lekë / 1,500.00 lekë)	2 kuota

Nëse pas një periudhe të caktuar çmimi i kuotës do rritej në 1,600 Lekë vlera e aseteve të anëtarit do jetë e barabartë me 2 (kuota) x 1,600 lekë = 3,200 lekë.

Kur një anëtar në Fond ndërpret, përkohësisht apo përgjithmonë, pagesën e kontributit, ligji nr.10197/2009 i jep të drejtë të mbetet anëtar në Fond me të drejta si anëtarët e tjerë të fondit të pensionit.

8 DETYRIMET TATIMORE

Sipas legjislacionit fiskal në fuqi:

1. Fondi NUK i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat, ose tatimit mbi vlerën e shtuar;
2. Kontributi i bërë nga çdo anëtar në Fond zbritet nga të ardhurat personale të tij, për efekt tatimi;
3. Kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e Fondit, NUK i nënshtrohen tatimit, as për vetë Fondin dhe as për shoqërinë administruese;
4. Kontributet e bëra nga punëdhënësi dhe çdo kontribuues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të Fondit, për efekte tatimore, NUK vlerësohen si të ardhura personale të anëtarit;
5. Në rast se anëtari në Fond është nën 50 vjeç, kufiri maksimal për lehtësitë tatimore për kontributet vjetore, është vlera më e vogël, që del nga krahasimi i shumës 200,000 lekë dhe 15% të të ardhurave vjetore bruto të anëtarit;
6. Në rast se anëtari është mbi 50 vjeç, kufiri maksimal për lehtësitë tatimore për kontributet vjetore është vlera më e vogël, që del nga krahasimi i shumës 250,000 lekë dhe 25% të të ardhurave vjetore bruto të anëtarit;
7. Blerja e kuotave të Fondit është shërbim financiar dhe, si rrjedhojë, është e përjashtuar nga TVSH-ja;
8. Shërbimet e ofruara nga depozitari për shoqërinë administruese dhe anëtarët vlerësohen si shërbim financiar dhe, si rrjedhojë, janë të përjashtuara nga TVSH-ja;
9. Tatimi, që shoqëron tërheqjen e parakohshme, është sa norma e zbatueshme në çastin e tërheqjes.

9 LEHTËSITË TATIMORE PËR PUNËDHËNËSIN

Kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në një plan pensioni profesional vlerësohen shpenzim operativ, deri në shumën vjetore për çdo punëmarrës, të barabartë me 250,000 lekë, dhe kjo shumë vlerësohet shpenzim i zbritshëm, për qëllime të tatimit mbi fitimin të punëdhënësit.

10 TRAJTIMI TATIMOR I PËRFITIMEVE TË MARRA NGA ANËTARI

Çdo pagesë e marrë nga anëtari i Fondit në momentin kur mbush kushtet ligjore për përfitim, tatóhet me tatimin mbi të ardhurat personale. Çdo ndryshim ligjor lidhur me trajtimin tatimor, do të reflektohet edhe në prospektin e Fondit.

11 PAGESA E PENSIONEVE

Shoqëria Administruese do të ushtrojë edhe veprimtarinë e kryerjes së pagesave të pensionit.

Çdo anëtar i Fondit, sipas zgjedhjes, ka të drejtë të përfitojë nga pagesa e menjëhershme e vlerës neto të aseteve në llogarinë e vet, ose nga pagesa periodike, në formë pensioni që i përgjigjen kësaj vlere vetëm kur përmbush kushtet e mëposhtme:

1. Kur mbush moshën e pensionit të parashikuar me ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm që zbatohet për atë anëtarë;
2. 5 vjet përpara se të mbushë moshën e pensionit të parashikuar me ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm;
3. Kur bëhet i paaftë për punë në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Me lindjen e së drejtës së marrjes së pagesës së pensionit, asetet e akumuluar mund të tërhiqen në format e mëposhtme:

1. Pagesa e menjëhershme ;
2. Pagesa periodike e planifikuar;
3. Përdorimin e vlerës neto të aseteve të llogarisë së vet, apo të një pjese të saj për të blerë një kontratë të sigurimit të jetës në formë "të përvitshme" të lëshuar nga një shoqëri e sigurimit të jetës.
4. Kombinimi i mënyrave të cituara në pikat 1, 2 dhe 3 më sipër.

Pagesa e menjëhershme e vlerës neto të aseteve do të kryhet në bazë të kërkesës me shkrim të Anëtarit, në llogarinë e tij, jo më vonë se 30 ditë nga dita e mbërritjes së kërkesës së vlefshme në Shoqërinë Administruese.

Pagesat periodike në formë pensioni do të kryhen mbështetur në një marrëveshje të veçantë që do të lidhet midis Anëtarit dhe Shoqërisë Administruese, kur Anëtari plotëson kushtet e parashikuara nga Ligji për të përfituar pension.

Më poshtë ilustrohen me shembuj skenarë të ndryshëm se si ndikon kohëzgjatja e periudhës së investimit në Fond, norma e kthimit dhe madhësia e kontributit në shumën në dispozicion në momentin e përfitimit të pensionit.

Shembujt janë ndërtuar vetëm për qëllime ilustruese dhe nuk duhet të merren për bazë për ndonjë pretendim apo garantim të rezultateve të tyre. Këto shembuj dhe të dhënat e paraqitura në to janë certifikuar nga znj. Brikena Xhaja, aktuar i njohur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Shembulli 1:

Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike	
Kontributet Mujore	10,000.00	Fondet në dispozicion për pension	8,357,263.80
Norma mesatare e interesit ndër vite	5%	Norma mesatare e interesit ndër vite	5%
Numri i viteve të investimit	30	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	20
Pagesë e menjëhershme	0	Numri i kësteve në vite	12
Totali i kontributeve të derdhura	3,600,000.00	Shuma e pensionit mujor (neto mbas tatimit)	46,686.58
Kontribute + interesa të akumuluar	8,357,263.80	Totali i interesit gjatë pensionit	4,824,828.91

Shembulli 2:

Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike	
Kontributet Mujore	10,000.00	Fondet në dispozicion për pension	6,963,629.02
Norma mesatare e interesit ndër vite	4%	Norma mesatare e interesit ndër vite	4%
Numri i viteve të investimit	30	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	20
Pagesë e menjëhershme	0	Numri i kësteve në vite	12
Totali i kontributeve të derdhura	3,600,000.00	Shuma e pensionit mujor (neto mbas tatimit)	42,058.03
Kontribute + interesa të akumuluar	6,963,629.02	Totali i interesit gjatë pensionit	3,130,297.85

Shembulli 3:

Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike	
Kontributet Mujore	50,000.00	Fondet në dispozicion për pension	41,786,318.98
Norma mesatare e interesit ndër vite	5%	Norma mesatare e interesit ndër vite	5%
Numri i viteve të investimit	30	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	20
Pagesë e menjëhershme	0	Numri i kësteve në vite	12
Totali i kontributeve të derdhura	18,000,000.00	Shuma e pensionit mujor (neto mbas tatimit)	252,375.62
Kontribute + interesa të akumuluar	41,786,318.98	Totali interesit gjatë pensionit	18,783,830.13

Shembulli 4:

Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike	
Kontributet Mujore	10,000.00	Fondet në dispozicion për pension	12,825,008.11
Norma mesatare e interesit ndër vite	5%	Norma mesatare e interesit ndër vite	5%
Numri i viteve të investimit	30	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	20
Pagesë e menjëhershme	1,000,000.00	Numri i kësteve në vite	12
Totali i kontributeve të derdhura	4,600,000.00	Shuma e pensionit mujor (neto mbas tatimit)	77,458.83
Kontribute + interesa të akumuluar	12,825,008.11	Totali interesit gjatë pensionit	5,765,111.16

Shembulli 5:

Faza e investimit për pension		Faza e marrjes së pensionit me pagesa periodike	
Kontributet Mujore	0	Fondet në dispozicion për pension	16,083,880.00
Norma mesatare e interesit ndër vite	5%	Norma mesatare e interesit ndër vite	5%
Numri i viteve të investimit	30	Kohëzgjatja e Pensionit në Vite	20
Pagesë e menjëhershme	3,600,000.00	Numri i kësteve në vite	12
Totali i kontributeve të derdhura	3,600,000.00	Shuma e pensionit mujor (neto mbas tatimit)	106,146.49
Kontribute + interesa të akumuluar	16,083,880.00	Totali interesit gjatë pensionit	9,391,277.40

12 TERHEQJA E PARAKOHSHME

Kur anëtari i Fondit kërkon të tërheq asetet e akumuluar në llogarinë e tij individuale pa përmbushur kriteret ligjore për të përfituar (të përshkruara në seksionin XI), kjo konsiderohet tërheqje e parakohshme, e cila shoqërohet me penalitetin e tërheqjes së parakohshme.

Në rastin e tërheqjes së parakohshme Shoqëria Administruese do të aplikojë penaltete mbi vlerën neto të aseteve, të cilat do të llogariten në raport me kohëzgjatjen e Anëtarit në Fond, dhe më konkretisht:

1. 2% për çdo tërheqje të parakohshme të kryer pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë;
2. 5%, për çdo tërheqje të parakohshme kryer në periudhën kohore që fillon pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 20 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 20-të;
3. 10%, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10-të;
4. 15%, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore deri në 5 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 5-të.

13 VDEK JA E ANETARIT

Nëse anëtari vdes përpara se të marrë pagesën e të gjitha aseteve të veta, asetet në llogarinë e tij do t'i shpërndahen trashëgimtarëve, në përputhje me dispozitat ligjore, që rregullojnë trashëgiminë.

14 PROCEDURA PËR TËRHEQJEN E ASETEVE NGA LLOGARIA INDIVIDUALE

Në rastin e pagesës së menjëhershme të aseteve të akumuluar, në bazë të një kërkesë me shkrim nga anëtari i Fondit, shoqëria administruese ia paraqet urdhrin Bankës Depozitare në mënyrë që ai të kryejë pagesën e totalit të aseteve të akumuluar në llogarinë individuale të anëtarit, brenda 30 ditësh nga dita e mbërritjes së kërkesës së vlefshme.

Në rastin e pagesës periodike të aseteve të akumuluar, midis anëtarit të Fondit dhe Shoqërisë Administruese do të nënshkruhet një marrëveshje mbi pagesat periodike. Anëtari i Fondit, në mënyrë të pavarur, përcakton shumën dhe frekuencat e pagesave periodike të cilat mund të ndryshohen me kërkesën e tij.

Sipas preferencës së anëtarit, shuma e pagesës periodike përcaktohet si numër kuotash ose si vlerë në lekë. Periudha e zgjedhur nga anëtari për përfitimin e aseteve të akumuluar si pagesë periodike nuk mund të jetë më pak se një vit. Anëtari në Fond ka të drejtën të blejë një anuitet duke lidhur një marrëveshje me një shoqëri të sigurimit të jetës, të cilën ai vetë e zgjedh. Në këtë rast, Shoqëria Administruese do të transferojë shumën e përcaktuar nga Anëtari në Fond, në shoqërinë e sigurimit të jetës të zgjedhur nga Anëtari, brenda 30 ditësh nga dita e mbërritjes së kërkesës së vlefshme.

Anëtarët mund të kërkojnë pagesa periodike me periodicitet jo më të shkurtër se një muaj. Shoqëria Administruese njofton anëtarët e Fondit 3 muaj para lindjes së të drejtës për përdorimin e aseteve neto në llogarinë e tij të pensionit.

15 PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES SË ANËTARËSISË NË FONDIN E PENSIONIT

Marrëveshja e anëtarësisë në Fond përfundon kur:

1. Anëtari fiton të drejtën për të tërhequr dhe përdorur asetet e akumuluar. Në këtë rast, marrëveshja e anëtarësisë do të përfundojë dhe do të kolaudohet një marrëveshje e re, e standardizuar, bazuar mbi mënyrën e tërheqjes dhe përdorimit të aseteve të akumuluar;
2. Anëtari vdes përpara moshës së pensionit;
3. Llogaria e anëtarit transferohet tërësisht në një Fond tjetër.

16 TRANSFERIMI I LLOGARISË INDIVIDUALE

Anëtari i Fondit ka të drejtë, që në çdo kohë, të transferojë asetet e veta nga një Fond Pensioni në një tjetër, i cili administrohet nga e njëjta ose nga një Shoqëri Administruese tjetër.

Anëtari, që ka vendosur të transferojë asetet e veta në një fond të ri pensioni, duhet të njoftojë paraprakisht Shoqërinë Administruese të Fondit ekzistues për vendimin e tij. Në këtë rast kontrata me shoqërinë e mëparshme administruese do të përfundojë. Një kontratë e re, me shoqërinë e re administruese do të nënshkruhet nga palët.

Transferimi i aseteve në Fondin e ri duhet të përfundojë jo më vonë se dita e parë e punës pas dhjetë ditësh pune, pasi shoqëria administruese e Fondit të mëparshëm të pensionit ka marrë njoftimin nga anëtari.

Transferimi nuk mund të kryhet nëse detyrimet e anëtarit ndaj Fondit të mëparshëm nuk janë shlyer.

17 TARIFAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

17.1 Tarifa e administrimit:

Tarifa e kostos së administrimit të Fondit do të mbahet nga asetet e Fondit. Ajo do të jetë 2.5% (dy pikë pesë përqind) në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit.

Tarifa e administrimit do të llogaritet në fund të çdo ditë dhe do të mbahet në ditën e fundit të çdo muaji si shumë e të gjitha vlerave ditore të muajit përkatës.

Shembull i mbajtjes së tarifës së Administrimit nga Shoqëria Administruese gjatë 1 (një) viti:

Kontributi në fillim të periudhës (në lekë)	50,000
Interesi i supozuar i rritjes së kontributit	6%
a) Vlera në fund të periudhës (në lekë)	53,000
b) Tarifa e administrimit	2.50%
c) Tarifa e administrimit në vlerë nominale (në lekë) (a*b)	1,325
Vlera Neto e Aseteve në fund të periudhës (a-c) (në lekë)	51,675

17.2 Tarifa e transferimit:

Në rastin kur anëtari i Fondit do të transferojë asetet e tij nga një fond pensioni në një fond pensioni tjetër, të menaxhuar nga e njëjta shoqëri administruese, nuk do të zbatohet tarifa e transferimit.

Në rastin kur anëtari i Fondit do të transferojë asetet e tij nga një fond pensioni në një fond pensioni tjetër, të menaxhuar nga një shoqëri tjetër administruese, tarifa e zbatueshme që mbulon koston e transferimit do të jetë në nivelin 0.5% (zero pikë pesë përqind) të shumës së transferuar.

17.3 Tarifa të tjera:

Përveç tarifave të sipërpërmendura, anëtari i Fondit është i detyruar që të kompensojë Shoqërinë Administruese për të gjitha shërbimet shtesë që i janë ofruar sipas kërkesës së tij. Këtu përfshihet kostoja e dërgimit të pasqyrave shtesë mbi llogaritë individuale me kërkesën e veçantë të anëtarit, shpenzimet postare, shpenzime të ndryshme bankare, etj.

18 BANKA DEPOZITARE

Shoqëria administruese ka lidhur një marrëveshje për shërbimin e depozitarit me Bankën e Tiranës Sh.a. regjistruar si person juridik shqiptar me Vendimin Nr.12718, datë 03.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, NIPT: J61924008V, me seli në Tiranë në adresën Rr. "Ibrahim Rugova", që vepron si bankë me Licencën nr.07, datë 12.09.1996 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë. Gjithashtu në bazë të vendimit Nr.23, datë 24.03.2010 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, është licencuar për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit si dhe është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbime depozitimi për asetet e fondit të pensionit me vendim Nr.2, datë 06.06.2019 (pa afat).

Funksionet e Depozitarit janë si më poshtë:

1. Llogarit vlerën neto të aseteve të Fondit dhe informon shoqërinë administruese, rregullisht dhe jo më rrallë se një herë në 30 ditë, për vlerën neto të aseteve të anëtarëve në Fond;
2. Kontrollon administrimin e aseteve të Fondit nga shoqëria administruese, në përputhje me dispozitat e kontratës së Fondit (planit të pensionit) dhe të legjislacionit në fuqi. Depozitari nuk duhet të kryejë asnjë veprim të kërkuar nga shoqëria administruese, që bie në kundërshtim me kontratën e Fondit të pensionit dhe me legjislacionin në fuqi;
3. Siguron që në transaksionet që përfshijnë asetet e Fondit, t'i kthehet Fondit çdo përfitim brenda afateve kohore të përcaktuara;
4. Siguron që të gjitha të ardhurat e Fondit shpërndahen në përputhje me kontratën e Fondit dhe me legjislacionin në fuqi;
5. Depozitari i mban asetet, veprimet dhe dokumentet e Fondit të ndara nga mjetet e veta, veprimet dhe dokumentet e tij.

19 EMRI DHE SELIA E AUDITUESIT TË JASHTËM

Audituesi i jashtëm i Shoqërisë Administruese dhe i Fondit të Pensionit nën administrim është:

NEXIA AL Shpk, i regjistruar me vendim nr. 110, datë 06.11.2006, në Regjistrin Publik të IEKA.

Me seli në adresën: Rr. "Ismail Qemali", Pall. 29/1, kati 3, Apt. 6, Tiranë, Shqipëri

NIPT: K91721010Q

Web: <https://www.nexia.al>

Tel: +355 4 223 2726

Audituesi i Jashtëm miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

20 SHOQËRIA ADMINISTRUESE

Albsig Invest Sha është një shoqëri aksionare, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me, NIPT: L92208025J, me seli në adresën: Rruga e Barrikadave, Albsig HG, 1001, Tiranë.

Aksionari i vetëm i shoqërisë administruese është "Albsig Jetë" Sh.a, e cila zotëron 100% të aksioneve.

Emri ligjor i shoqërisë është: ALBSIG INVEST SHA — Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.

Kapitali i nënshkruar dhe i paguar i shoqërisë është 54,000,000 (pesëdhjetë e katër milionë) lekë.

Albsig Invest Sh.a ka si objekt të aktivitetit të saj:

1. Mbledhja dhe investimi i fondeve të pensioneve, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10197/2009 "Për fondet e pensionit vullnetar", si dhe në përputhje me parimin e shpërndarjes së rrezikut (diversifikimit), për ofrimin e përfitimeve të pensionit për personat që bashkohen në fondin e pensionit. Shoqëria, do të ketë edhe funksionin e kryerjes së pagesave të pensionit;
2. Krijimin dhe/ose administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive sipas ligjit 10198/2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", i ndryshuar dhe aktet nënligjore/rregullatore.

21 FONDET NËN ADMINISTRIM

Albsig Invest Sh.a. ka nën administrim fondet të mëposhtme:

- Fondi i Pensionit Vullnetar Albsig (Ref. FP 4) miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me vendimin nr. 210, datë 22/11/2019.
- Fondi i Investimit Albsig Standard (Kodi F1-B5) miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me vendimin nr. 255, datë 30/12/2019.

22 ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Organet drejtuese të shoqërisë administruese janë: Asambleja e aksionarëve, Këshilli i Administrimit, dhe Administratorët.

22.1 Asambleja e Aksionarëve:

Asambleja e aksionarëve përbëhet nga përfaqësuesi ligjor i aksionarit të vetëm të shoqërisë - "Albsig Jetë" Sh.a.

22.2 Këshilli i Administrimit:

Këshilli i Administrimit është organi qendror i shoqërisë administruese i cili kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit të shoqërisë administruese. Ai kujdeset që shoqëria administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit, miraton politikat financiare, të investimit, prospektin etj. Këshilli përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë si më poshtë:

1. Z. Irfan LAMI: Kryetar i Këshillit të Administrimit

Z. Irfan Lami ka karrierë të gjatë në fushën financiare prej vitit 1995. Z. Lami ka eksperiencë disavjeçare pranë ISSH në fushën e pensioneve, financës dhe auditimit. Gjithashtu ka eksperiencë mbi 18 vjeçare në menaxhimin financiar dhe drejtues të shoqërive të sigurimeve në Shqipëri dhe Kosovë. Prej vitit 2015 është Drejtor i Departamentit të Financës të Shoqërisë Albsig Sh.a. Irfani zotëron diplomë universitare e integruar e nivelit të dytë në Financë që nga viti 1995. Ai ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit financiar dhe të rrezikut. Z. Irfan Lami nuk është palë e lidhur me asnjë nga aksionarët dhe me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

2. Z. Dritan KASTRATI: Anëtar i Këshillit të Administrimit

Z. Dritan Kastrati ka një eksperiencë disavjeçare pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, si specialist i trajtimit të dëmeve, sekretar i Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve/Komisioneve dhe administrimit të praktikave të BSHS. Dritani prej vitit 2015 është pjesë e Albsig Sh.a si Drejtor i Departamentit të Dëmeve dhe Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm. Z. Kastrati zotëron diplomë universitare master në administrim publik. Ai ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit (publik dhe të shoqërive private), të sigurimeve, trajtimit të dëmeve dhe rrezikut. Z. Dritan Kastrati nuk është palë e lidhur me asnjë nga aksionarët dhe me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

3. Z. Elvis BEQIRI: Anëtar i Këshillit të Administrimit

Z. Elvis Beqiri prej vitit 2017 është pjesë e shoqërisë Albsig Sh.a si Drejtor i Sigurimit të Përgjegjësive. Elvsi ka një eksperiencë 14 vjeçare në fushën bankare në pozicione të ndryshme si Drejtor Departamenti, Drejtues Dege, etj. Z. Beqiri zotëron diplomë universitare master në fushën e Administrimit të Biznesit. Ai ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit dhe financiare. Z. Elvis Beqiri nuk është palë e lidhur me asnjë nga aksionarët dhe me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

4. Z. Elton KORBI: Anëtar ekzekutiv i Këshillit të Administrimit

Z. Elton Korbi është aktualisht Administrator i Përgjithshëm i Albsig Invest Sh.a. Ai ka një eksperiencë mbi 13 vjeçare në sektorin bankar në bankat tregtare dhe në Bankën e Shqipërisë, në fushën e auditimit, mbikëqyrjes dhe analizës financiare. Z. Korbi zotëron diplomë universitare të integruar të nivelit të dytë në Financë nga Universiteti i Tiranës

si dhe diplomë master në Administrim Biznesit (MBA) nga Universiteti Epoka. Që nga viti 2015 është duke ndjekur studimet për marrjen e certifikatës ACCA. Eltoni ka zhvilluar trajnime të shumta në fushën e auditimit, mbikëqyrjes, menaxhimit të rrezikut dhe menaxhimit financiar nga institucione prestigjioze si Banka Botërore, Deutsche Bundesbank, Banque de France, etj. Z. Elton Korbi nuk është palë e lidhur me asnjë nga aksionarët dhe me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

5. Z. Admir RAMADANI: Anëtar ekzekutiv i Këshillit të Administrimit

Z. Admir Ramadani është aktualisht Drejtor i Investimeve dhe Zëvendës Administrator i Përgjithshëm i Albsig Invest Sh.a. Admiri ka një eksperiencë 13 vjeçare në sektorin financiar, nga të cilat 5 vjet në fushën e investimeve si dhe 8 vite në fushën e rreziqeve financiare. Z. Ramadani zotëron dy diploma nga Universiteti Amerikan në Bullgari në Ekonomiks dhe Matematikë. Ai zotëron titullin CFA që nga tetor 2012. Z. Admir Ramadani nuk është palë e lidhur me asnjë nga aksionarët dhe me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

23 ADMINISTRATORËT

Veprimtaria e përditshme e Shoqërisë Administruese menaxhohet nga Administratorët të cilët janë edhe Anëtar të Këshillit të Administrimit. Administratorët organizojnë dhe menaxhojnë veprimtarinë e Shoqërisë Administruese, përgatisin dhe propozojnë për miratim në Këshillin e Administrimit politikat e biznesit, rregulloret dhe procedurat e brendshme, raportet e zhvillimit të biznesit si dhe raportet financiare, vendosin mbi të drejtat dhe detyrimet e punonjësve që rrjedhin nga kontratat e punës. Administratorët janë:


1. Z. Elton KORBI - Administrator i Përgjithshëm, Anëtar ekzekutiv i Këshillit të Administrimit;
2. Z. Admir RAMADANI - Zëvendës Administrator i Përgjithshëm, Anëtar ekzekutiv i Këshillit të Administrimit.

ALBSIG INVEST sh.a.
NUIŠ: L92208025J

 +355 (0) 42254764

 info@albsiginvest.al

 www.albsiginvest.al

 Rr. "Barrikadave", Albsig HQ, Kati 8,
Tiranë - Shqipëri



PJESË E
KASTRATI GROUP